



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:020142
Datë: 13.02.2025
Numri i dokumentit: 06848635

C.nr.171/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.Sh. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, kundër të paditurve N.G. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.G. nga Prizreni dhe K.R.U. "H.J." Sh.A. Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson S.Zh. nga Prizreni, me objekt kontesti pasurim i pabazë, vlera e kontestit 1,990.25 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 13 .02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Sh.Sh. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *"OBLIGOHET i padituri N.G. nga fshati Komuna e Prizrenit, që i njëjti në emër të harxhimeve të ujit për shfrytëzimin e lokalit afarist që është pronë e palës paditëse, t'i kthej shumën prej 1,990.25 euro, brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishëmrisë së këtij aktgjykimi, Obligohet e paditura K.R.U. "H.J." në Prizren, që llogaritjen e harxhimeve të ujit për lokalit e paditësit ta bëjë sipas kriterëve të përcaktuara sipas urdhëresës tarifore, të shërbimeve, e jo sipas mënyrës paushallë si dhe Obligohen të paditurit që paditësit të i paguajnë shpenzimet e kësaj procedure në lartësi prej 478.00 euro"*, si e **pa bazuar**.

II. DETYROHET paditësi, që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajnë të paditurit të parë N.G. shumën në lartësi prej 270.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi Sh.Sh. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. N.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 03.02.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurve N.G. nga fshati Komuna e Prizrenit dhe K.R.U. "H.J." Sh.a. Prizren, me objekt të kontestit pasurim i pabazë, vlera e kontestit 2,543.73 euro. Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësi është pronarë i paluajtshmërisë që evidentohet në certifikatën

nga njësia kadastrale me nr. 11002-7 ZK Prizren, po ashtu nuk është kontestues fakti se në vitin 2004, paditësi me të paditurin e rendit të parë N.G. nga fshati kanë lidhur kontratë mbi qiranë, me të cilin i padituri N. ka marrë për obligim që pronarit të lokalit t'i paguaj qiranë mujore nga 150.00 euro në muaj si dhe të i pagujë anuitetet si harxhimet për përdorimin e ujit, rrymës etj. Në vazhdim ka theksuar se paditësi në ndërkohë ka kuptuar se pala e paditur e rendit të parë N. po manifeston opstrukcion lidhur me këtë lokal dhe të njëjtit pa marrëveshje me pronarin, po e ndërron destinacionin, andaj paditësi për të evituar shkaktimin e ndonjë dëmi të riparueshëm lidhur me lokalin e tij, që nga viti 2017, e merr në posedimin e vet lokal dhe N. largohet nga lokali. Më tej ka theksuar se e paditura e rendit të dytë K.R.U. "H.J." Sh.A. Prizren, ka lëshuar faturë me të cilën këtu palën paditëse në emër të harxhimeve të ujit për lokalin në fjalë e obligon që të paguaj shumën e të hollave prej 2,453.73 euro, pra shfrytëzuesi i këtij lokali N.G. nuk ka paguar asgjë në emër të harxhimit të ujit gjatë shfrytëzimit të këtij lokali, që de fakto i njëjti është pasuruar pabazë për mos pagimin e këtij borxhi që po ngarkohet paditësi dhe me të cilin rast kemi shtimin e pasurisë në llogari të të paditurit e dëm të pasurisë së paditësi të parapara me nenin 194 të LMD-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit.

I padituri i parë në përgjigjen në padi ka theksuar se padia është e pabazë dhe e njëjta duhet të refuzohet. Në vazhdim ka theksuar se nga padia e këtu paditësit dhe në bazë të provave të cilat janë bashkangjitur me padi po del që i padituri është N.G. nga fshati pa asnjë shënim tjetër për të paditurin, emrin e babës, nr. personal, me arsyetimin që në fshatin ka disa persona me emrin N.G. po ashtu këtu i padituri N.G. prej vitit 2000 deri kur ka dalur në pension në vitin 2023 ka punuar vetëm si polic dhe në bazë të ligjit i njëjti nuk ka pasur mundësi për të punuar edhe një punë tjetër. Më tej ka theksuar se nga kontratat të cilat janë bashkangjitur bashkë me padi konstatohet që sikurse kontratën e kanë lidhur Sh.Sh. si pronarë i lokalit dhe N.G. si shfrytëzues i lokalit dhe atë me afat 6 mujor për periudhën prej 01.07.2004 deri më 31.10.2004. Së pari kontrata nuk ka asnjë formë si kur është lidhur kontrata, shënimet e kontraktuesve, emri dhe mbiemri i babës, kontrata është sikurse i lidhur për periudhën prej 01.07.2004 deri më 31.10.2004, ndërsa padia në gjykatë është dorëzuar me datën 03.02.2021, po ashtu nga shiqimi në kartelën e financiare të konsumatorit dhe si janë shënuar obligimet konstatohet që borxhi është për vitin 2019 dhe 2020, 15 vite pas skadimit të kontratës.

I padituri i dytë K.R.U. "H.J." Sh.a. në Prizren, në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit dhe atë duke u thirrur se ujëmatësi me shifër KONS-0026618, është i evidentuar në emër të paditësit Sh.Sh. (çajtores), andaj edhe është kërkuar nga ai si pronarë pagesa e borxhit për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar.

I autorizuari i paditësit av. N.K. në seancën përgaditore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi nga të dhënat që janë cekur në padi dhe kërkesës së saj, pas administrimit të provave do të vërtetohet besueshmëria e kësaj kërkesëpadie dhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta aprovoj. Në fjalën përfundimtare të cilën gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim ka theksuar se paditësi si qiradhënës dhe i padituri N.G. si qiramarës kanë lidhur kontratë për marrjen e lokalit me qira, të cilin lokal i padituri i parë N.G. e ka mbajtur deri në vitin 2017. Mirëpo kur paditësi e ka marrë lokalin e tij në posedim në vitin 2017, tek i njëjti ka ardhur inspekcioni dhe me procesverbal të shkruar ka konstatuar gjendjen e harxhimit

të ujit për periudhën paraprake gjerë në datën 14.12.2017 dhe ka konstatuar se paditësi duhet të paguaj borxhin prej 1990.25 euro, në emër të harxhimit të ujit për këtë lokal. Ky fakt vërtetohet me shiqimin e këtij procesverbal me nr. 02225, të datës 14.12.2017, lëshuar nga K.R.U. "H.J." Prizren. Pra në këtë procesverbal është konstatuar borxhi të cilin duhet ta paguaj paditësi, ndërsa për kohën kur paditësi dhe i padituri i rendit të parë me kontratëat e kanë shkruar dhe në të njëjtën në mënyrë taksative është konstatuar se N.G. është i detyruar që të bëjë pagesën e energjisë elektrike, ujit dhe shpenzimet tjera komunale për këtë lokal që e ka marrë me qira. Nga këto rrethana shihet se i padituri i parë N.G. me mos pagimin e harxhimit të ujit për lokalin që e ka marrë me qira, për tërë periudhën nga viti 2004 gjerë në kohën e dorëzimit në vitin 2017, tani i njëjti është pasuruar pabazë ligjore, nga fakti se për këtë shumë të hollash në lartësi prej 1990.25 euro, është ngarkuar dhe e ka paguar palën paditëse, ndërsa i padituri i dytë në të ardhmen duhet të bëjë llogaritjen e sasisë së ujit që po harxhohet të faturohet sipas kriterëve të përcaktuara sipas urdhëresës tarifore, e jo sipas mënyrës paushallë, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit, të obligohet i padituri N.G. që i njëjti në emër të harxhimeve të ujit për shfrytëzimin e lokalit afarist që është pronë e paditësit, t'i kthej shumën prej 1999.25 euro, po ashtu obligohet e paditura K.R.U. "H.J." në Prizren, që llogaritjen e e harxhimeve të ujit për lokalin e paditësit, të bëjë sipas kriterëve të përcaktuara sipas urdhëresës tarifore, e jo sipas mënyrës paushallë, Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 478.00 euro

I autorizuari i të paditurit të parë av. E.G. përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se padia në kuptimin objektiv dhe subjektiv është e mangët dhe që në fillim gjykata është dashur ose ta hedh poshtë ose ta kthej në plotësim ngase kemi të bëjmë me pasurim të pabazë në petitum të padisë, ndërsa në dispozitiv kërkohet shuma që është harxhuar për shfrytëzimin e ujit të cilën shumë a e ka paguar apo jo nuk është me rëndësi por çfarë pasurimi pabazë ka bërë Nexhmidin Gashi. Pavarësisht kësaj kemi edhe një kontratë të cilën e ka bashkangjitur me padi e cila nuk i përmbush kushtet minimale të cilat i kërkon ligji. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe dy kontratave, konsiderojnë se një padi e tillë nuk mund të aprovohet nga në mënyrë të qartë ligjet në fuqi e përcaktojnë se kontrata duhet t'i përmbaj elementet qenësore të përcaktuara me ligj pa u caktuar në këto dy kontrata ngase mungojnë të dhënat elementare për të paditurin N.G. mungon shprehja e vullnetit, obligimet, të drejtat dhe detyrat që një kontratë të prodhojë efekte juridike. Po ashtu ka theksuar shumë me rëndësi është se edhe padia vet si e tillë jo vetëm që nuk është e kjo sepse kemi dy të paditur N.G. dhe K.R.U. "H.J." Sh.A. Prizren, me çka lidhet i padituri i parë dhe i dytë, çfarë lidhje kauzale kanë, kur Nexhmidini nuk ka asnjë marrëveshje me H.J. po ashtu nga H.J. nuk kemi ndonjë faturë apo ngarkesë në emër të N.G. që është shfrytëzues i ujit në këtë lokal, po ashtu ka deklaruar se parashtrohet pyetja se N.G. me çfarë shume apo sasi është pasuar, prandaj I propozon gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë të refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për dy seanca nga 135.00 euro, gjithsej 270.00 euro

E autorizuar e të paditurit të S.Zh. në seancën përgaditore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbeten pranë pëëgjigjes në padi. Në fjalën përfundimtare të cilën gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim ka theksuar ka theksuar se e paditura e kundërshton padinë

dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe në tërësi ngel si në përgjigjen në padi dhe theksimeve se seancat paraparake. K.R.U. "H.J." Sh.A. me seli në Prizren në këtë çështje nuk mundet me qenë palë e paditur për pasurim të pabazë, ngase e paditura nuk ka inkasuar mjete monetare për shërbime të ujsjellësit dhe kanalizimit, kjo e cila vërtetohet me kartelën e klientit, andaj nuk kemi pasurim të pabazë, nga të theksuarat më lartë ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ndaj K.R.U. "H.J." Sh.A në Prizren, të hedhë poshtë si të pa bazuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: dëgjimin e paditësit Sh.Sh. në cilësi të palës në shqyrtimin e datës 02.09.2024 dhe datës 16.09.2024, dëgjimin e të paditurit të parë N.G. në cilësi të palës në shqyrtimin e datës 16.09.2024 kontratat e nënshkruara nga palët ndërgjyqëse, çertifikatën pronësore, e datës 14.07.2020, për ngastrën kadastrale 11002-7 ZK Prizren, kartelën financiare të konsumatorit nga K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren, e datës 01.12.2020, procesverbalin e përpiluar nga K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" me nr. 02225, i datës 14.12.2017, vërtetimin tatimor me nr. 1001176099, të lëshuar nga ATK, pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën kohore prej datës 01.08.2022 deri me datë 25.06.2024.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 02.09.2024 dhe datës 16.09.2024, e ka bërë dëgjimin e paditësit Sh.Sh. në cilësi të palës në të cilën ka deklaruar se N. së bashku me Y.G. kanë ardhur tek unë dhe kanë kërkuar lokalin tim, të cilin lokal unë ia kam dhënë me qira N.G. i njëjti fillimisht e ka shfrytëzuar lokalin me sa di unë si zyre me djalin e tij dhe këtë e ka bërë pas orës 4, sepse me aq sa kam informata i njëjti ka qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës. Fillimisht marrëveshja me N. ka qenë gojore më pas i kemi përgaditur kontratat, i njëjti qiranë sipas kësaj marrëveshje e ka paguar por kanë mbetur pa u paguar shërbimet komunale. Sa i përket borxhit për të cilin bëhet fjalë unë jam njoftuar në vitin 2017, ku Hidroregjioni mua më ka ngarkuar padrejtësisht dhe atë për 10 vite në mënyrë paushallë, ku për këtë nuk kanë pasur të drejtë sepse në atë lokal më shumë se 3 euro ujë nuk kam paguar asnjëherë. Mirëpo këtë borxh unë nuk e kam pranuar dhe i kam treguar Hidroregjionit se lokalin në fjalë me anë të një kontrate me qira ia kam dhënë N.G. ku për këtë faturim kam paraqitur ankesë por e njëjta është refuzuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 16.09.2024 dhe datës 16.09.2024, e ka bërë dëgjimin e të paditurit të parë N.G. në cilësi të palës në të cilën ka deklaruar se Sh.Sh. e kam njohur më përpara përmes kushëririt tim Y.G. mbi 20 vite, ndërsa Y.G. është i fshatit tim dhe ka qenë moshatar me mua. Në vazhdim ka theksuar se Y.G. ka pasur dyqanin e paditësit dhe ka ndodhur që kemi pirë kafe në këtë lokal, për sa e ka mbajtur me qira unë nuk e di, por e di se paditësi ia ka dhënë më qira lokalin atij. Sa i përket kontratave i njëjti ka deklaruar se nuk e kam nënshkruar asnjë kontratë për të cilat bëhet fjalë, nuk është nënshkrimi im dhe se paditësit

nuk ia ka paguar asnjë shumë, po ashtu ka deklaruar se asnjëherë nuk ka paguar dhe as nuk ka pranuar ndonjë kërkesë nga Hidroregjioni Jugor.

Nga shiqimi i “dokumenteve” të emërtuara kontratë të nënshkuara nga palët ndërgjyqëse, gjykata ka vërtetuar faktin se Sh.Sh. si pronarë i lokalit ka arritur marrëveshje me N.G. si qiramarrës për shfrytëzimin e lokalit. Kjo kontratë nuk është përpiluar në formën e paraparë ligjore ngase i mungojnë elementet thelbësore të saj ku saktësisht nuk janë të përcaktuara drejtat dhe detyrimet.

Nga shiqimi i çertifikatës pronësore e datës 14.07.2020, për ngastrën kadastrale 11002-7 ZK Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo parcelë gjendet në zonën kadastrale Prizren në vendin e quajtur “Kadri Zeka”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 21 m², e cila evidentohet në emër të Sh.Sh. me 1/1.

Nga shiqimi në kartelën financiare e periudhës 01.12.2020, e cila evidentohet në emër të Sh.Sh. me nr. KONS-0026618, e lëshuar nga K.R.U. “Hidroregjioni Jugor”, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi për periudhën 01.01.2019-01.12.2020 nuk ka bërë asnjë pagesë ndaj K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” ndërsa borxhi deri më 01.01.2019 ka qenë 2,233.92 euro. Nga shiqimi në procesverbalin e përpiluar nga K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” me nr. 02225, i datës 14.12.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se konsumatori Sh.Sh. ka bërë ankesë për paushallin e faturuar.

Nga shiqimi në vërtetimin tatimor me nr. 1001176099, të lëshuar nga ATK, gjykata ka vërtetuar faktin se N.G. është i regjistruar në ATK, por nuk ka biznes të regjistruar në emrin e tij.

Nga shiqimi në pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën kohore prej datës 01.08.2022 deri me datë 25.06.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se N.G. trusti i është paguar vetëm nga Ministria e Financave.

Baza Ligjore

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), shprehimisht përcaktohet se: *“Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”*. Më tutje, me nenin 194 par. 3 të LMD-së, parashihet që: *“Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket”*. Po ashtu me nenin 195 të po këtij ligji parashihet *“Kush kryen pagesën duke ditur se nuk e ka për detyrë ta paguajë nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin, përveç nëse e ka rezervuar të drejtën e kërimit të kthimit, apo në qoftë se e ka paguar për t’iu shmangur dhunës”*. Ndërsa duke u bazuar në nenin 7.1 të LPK-së i cili përcakton se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, lidhur me nenin 319 par.1 të këtij ligji i cili përcakton se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”* dhe nenin 322.1 të këtij ligji i cili përcakton se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8) nuk mund të konstatoj me siguri një fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Për gjykatën, por edhe për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është pronar i lokalit e cila gjendet në ZK Prizren në vendin e quajtur “Kadri Zeka”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 21 m². Kontestuese ishte nëse palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontrata për shfrytëzimin e lokalit të paditësit dhe nëse i padituri i parë N.G. në emër të harxhimeve të ujit për shfrytëzimin e lokalit afarist që është pronë e paditësit a ka mbetur pa e paguar shumën prej 1,990.25 euro.

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë kontestimore, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar edhe se e njëjta duhet refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo për faktin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar gjykata vlerëson se “dokumentet” e emërtuara si kontratë gjykata nuk mund të ia fal besimin për shkak se këto “kontrata” nuk janë përpiluar në formën e paraparë ligjore ngase të njëjtat nuk i përmbajnë elementet thelbësore të kontratës (nuk i kanë të dhënat personale të palëve kontraktuese, nuk kanë datë se kur janë lidhur, nuk i kanë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet). Po ashtu nga kartela e konsumatorit të lëshuar nga K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” në Prizren vërtetohet se e paditura e dytë nuk ka inkasuar mjete monetare nga paditësi, po ashtu nga pasqyra e trustit vërtetohet se i padituri i parë N.G. e ka marrë pagën vetëm nga thesari i Ministrisë së Financave. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ka pasurim të pabazë pasi që asnjëri prej palëve të paditura nuk është pasuruar pasi që nuk kanë marrë shumën prej 1,990.25 euro, po ashtu edhe paditësi asnjërit prej palëve të paditura nuk i ka paguar këtë shumë. Për më tepër me rastin kur flitet për pasurim pabazë duhet pasur parasysh faktin se për të ekzistuar kjo fillimisht duhet dikush të pasurohet e dikush të varfërohet e në rastin konkret nuk kemi asnjërën nga këto. Andaj duke u bazuar edhe në nenin 322 paragrafi 2 të LPK-së në të cilin shprehimisht parashihet se “*Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër*” Përfundimisht, gjykata vlerëson se barra e të provuarit mbi çështjen e vërtetimit të pasurimit të pabazë i bie palës paditëse dhe se për faktet të cilat i ka parashtruar duhet të ofrojë edhe prova relevante për vërtetimin e fakteve të pretenduara, andaj pretendimet e paditësit në mungesë të provave mbeten vetëm supozime të pa vërtetuara.

Ndërsa sa i përket kërkesës tjetër të paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” në Prizren që llogaritjen e harxhimeve të ujit në lokalit e paditësit ta bëjë sipas kriterëve të përcaktuara sipas urdhëresës tarifore të shërbimeve e jo sipas mënyrës paushallë, gjykata e gjeti si të pa bazuar për faktin se gjykata nuk ka kompetencë që të urdhëroj K.R.U. “Hidroregjionin Jugor” se si duhet të bëjë llogaritjen e harxhimeve të ujit, ngase ajo është procedurë e brendshme e tyre dhe rregulloret me aktet e brendshme të tyre.

Gjykata i ka pasur parasysh dhe të njëjtën kohë i ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 dhe par.1 dhe 463 par,1 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve e datës 18 mars 2017 dhe atë duke e obliguar paditësin i cili e ka humbur kontestin, që të paditurit të parë t’ia kompensoj shpenzimet procedurale dhe atë për përfaqësimin në 2 seanca gjyqësore nga 135.00 euro (135.00 x2) apo shumën prej 270.00 euro.

Numri i lëndës: 2021:020142

Datë: 13.02.2025

Numri i dokumentit: 06848635

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:020142, 13.02.2025

B. Profesional

Ali Kosova

Gjyqtari,

Agron Karatah

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtës, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.